

## **SHTYLLA III: SUNDIMI I LIGJIT**

### **I. FUNKSIONET E KUVENDIT, ROLI MBIKËQYRËS DHE MONITORUES**

#### **I.4 ZGJEDHJA E INSTITUCIONEVE TË PAVARUARA**

*(Përmbledhje ekzekutive)*

Shqipëria ka bërë përparime në forcimin e institucioneve të saj të pavarura, të cilat janë thelbësore për qeverisjen demokratike dhe për integrimin në Bashkimin Evropian, megjithatë, zgjedhja e drejtuesve të këtyre institucioneve shpesh është përballur me bllokime për shkak të mungesës së transparencës dhe mosmarrëveshjeve politike, gjë që ka vënë në pikëpyetje meritokracinë.

Analiza përqendrohet në dy çështje kryesore: përputhshmërinë e procesit të emërimeve me parimet e meritokracisë dhe transparencës, dhe mekanizmat për zgjidhjen e bllokimeve politike.

Pavarësia e institucioneve të pavarura është një element kyç në sistemin e peshave dhe kundërpeshave të demokracisë shqiptare, por mbeten ende sfida për depolitizimin e tyre. Komisioni Evropian, por edhe organizata të tjera ndërkombëtare, kanë theksuar nevojën për reforma për të siguruar pavarësinë e këtyre institucioneve nga ndikimi politik.

Raportet e BE-së për Shqipërinë, veçanërisht ato të viteve 2023 dhe 2024, kanë ngritur shqetësime mbi ndikimin e partive politike në procesin e emërimit të drejtuesve të institucioneve të pavarura. Ndërsa reforma në drejtësi ka përmirësuar emërimet me meritë në sistemin gjyqësor, *ka nevojë për modele të ngjashme, në emërimin e drejtuesve të institucioneve të tjera.*

Sfidat kryesore përfshijnë ngadalësimin e procesit të emërimeve për shkak të polarizimit politik, i cili ka ndikuar negativisht në pavarësinë dhe efektivitetin e institucioneve, si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi etj.. Për të përmirësuar situatën, *Shqipëria duhet të përshpejtojë procedurat e emërimit dhe të sigurojë që këto organe të veprojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare.*

## **PROBLEMATIKA DHE SFIDA**

Meritokracia është parimi sipas të cilit emërimet në pozicione publike duhet të bazohen në kualifikimet, kompetencën dhe integritetin e kandidatëve, dhe jo në përkatësinë politike. Në Shqipëri, megjithatë, procesi i zgjedhjes së drejtuesve të institucioneve të pavarura shpesh ndikohet nga marrëveshjet politike, duke lënë pas dore transparencën dhe meritokracinë. Nominimet me sfond politik dhe votimi në Kuvend shpesh bëhen pa një shqyrtim të hapur dhe të bazuar në meritë, duke ngritur shqetësime për besnikëri politike mbi kompetencën profesionale.

Raporti Vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2023 dhe Raporti i Shqyrtimit Analitik për Grup Kapitullin 1 “Themelorët” 2023 konstatojnë se këto procese emërimesh shpesh vonohen për shkak të negociatave politike, gjë që ndikon negativisht në pavarësinë dhe autoritetin e institucioneve si AMA. Formula zgjedhore dypartiake dhe lidhjet politike të disa anëtarëve të bordit të AMA-së kanë ngritur pikëpyetje mbi pavarësinë e këtij institucioni.

*Për të përmirësuar situatën, duhet adresuar transparencën në procesin e nominimeve, përfshirë konsultimet publike dhe debatin e hapur. Përfshirja e shoqërisë civile në procesin e nominimit dhe organizimi i seancave dëgjimore publike për kandidatët mund të rrisin llogaridhënien dhe besimin publik. Konsensusi politik është gjithashtu i nevojshëm për të siguruar funksionimin e institucioneve të pavarura dhe legjitimitetin e tyre.*

## **ÇËSHTJET PËR ZGJIDHJE / DREJTIMET E NDËRHJRJEVE**

Shqipëria ka bërë disa përmirësime në zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të pavarura, por mbeten ende sfida lidhur me meritokracinë, transparencën dhe konsensusin politik. Për të adresuar sfidat që lidhen me procesin e zgjedhjes së drejtuesve të institucioneve të pavarura në Shqipëri, mund të *propozohet një grup ndërhyrjesh strukturore dhe ligjore të ngjashme me modelet që përdoren në vende të ndryshme evropiane ndër të cilat përmendim si më poshtë:*

- **Krijimi i një kornize ligjore për emërimet të bazuara në meritë**

Legjislacioni duhet të përcaktojë qartë kriteret e përvojës profesionale të matshme, kredenciale akademike të rëndësishme për fushën përkatëse dhe integritet të lartë, të verifikuar përmes një procesi të ngjashëm me vetingun gjyqësor. Për të siguruar një proces të drejtë dhe transparent, duhet të krijohet një sistem uniform për nominimin, vetingun dhe emërimin e drejtuesve të institucioneve. Ky proces duhet të përfshijë përveç njoftimeve publike për pozicionet e hapura që kryhen rregullisht, edhe marrjen e mendimeve nga grupe të pavarura me ekspertë të fushave përkatëse para vendimmarrjes. Kjo do të ulte rrezikun e ndikimit politik dhe do të forconte meritokracinë.

- **Prezantimi i mekanizmave të transparencës dhe kontrollit publik**

Në seancat publike për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidatëve duhet lejuar që shoqëria civile, media dhe aktorët e interesuar të japin komente mbi kandidatët. Mund të propozohet ndërtimi i një platforme digjitale të dedikuar për procesin e emërimit të drejtuesve të institucioneve të pavarura.

- **Forcimi i pavarësisë së procesit të emërimit**

Krijimi i komisioneve të pavarura të përzgjedhjes për emërimin e drejtuesve të institucioneve të pavarura do të ndihmonte në minimizimin e ndikimit politik në proces. Këto komisione mund të përbëhen nga anëtarë jopartiakë, përfshirë ekspertë nga akademia, shoqëria civile dhe gjyqësori, duke siguruar një vlerësim të drejtë dhe objektiv të kandidatëve.

- **Mekanizmat për zgjidhjen e bllokimeve politike në emërime**

Legjislacioni duhet të parashikojë mekanizma zhblokues për të zgjidhur bllokimet politike në procesin e emërimit. Nëse partitë politike dështojnë të arrijnë një marrëveshje për emërimin e një drejtuesi të institucionit, një institucion apo komision neutral mund të ndërhyjë për të lehtësuar një zgjidhje.

- **Përfshirja e Shoqërisë Civile dhe Medias**

Organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat profesionale duhet të fuqizohen për të marrë pjesë në procesin e nominimit dhe emërimit. Ligji duhet të njohë rolin e medias si mbikqyrëse e pavarur në procesin e emërimeve. Mbrojtja ligjore për gazetarinë hulumtuese duhet të forcohet për të siguruar që media të mund të hetojë dhe raportojë lirisht lidhur me sfondin e kandidatëve dhe për procesin e emërimit, pa u frikësuar nga ndëshkimet politike.

Hartuar nga Ekspertët e Nivelit të Lartë:

Dr. Emilio Çika  
Gledis Gjipali MSc  
Elona Hoxhaj, MSc  
Krisi Kllapi MSc